



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion dhe ndërtim çatie për ndërtesën (objektin) e Njesisë Administrative Gradishtë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (CPV): 45000000-7 Punë ndërtimi, (CPV): 45210000-2 Punime ndërtimi, (CPV): 45410000-4 Suvatim, (CPV): 45261420-4 Punime hidroizolimi, (CPV): 45332200-5 Punime hidraulike, (CPV): 44112400-2 Çati

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,320,375.19 (tetë milion e treqind e njëzetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë e nëntëmbëdhjetë të qindat) lekë pa Tvsh nga Të ardhura të trashëguara nga të ardhurat vendore

Burimi i financimit: Të ardhura të trashëguara nga të ardhurat vendore

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në Nenin 76, pika 1, gërma a të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si edhe në “Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim” i gjeneruar nga portali e-Albania më datë 16.07.2026.

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Nenit 2, pika 2, gërma c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, Nenin 82 dhe Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe në Nenin 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Konkretisht, njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1, gërma a dhe pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe në nenin 39, pika 6, gërma b të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2023, 2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si dhe në Nenin 43 pika 1, pika 2, gërma c dhe pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në Nenin 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2, gërma c citohet: 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në referencë, është bërë që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në Nenin 77, pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në Nenin 43 pika 1, pika 2, gërma c dhe pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 **“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar, si edhe në Ligjin Nr.29/2023 **“Për Tatimin mbi të Ardhurat”** i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2, gërma c, të Nenit 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 **“Për sistemin e taksave vendore”** i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe këstet e maturuara të vitit 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe këstet e maturuara të vitit 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar, është vënë për të patur një informacion sa më koherent, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore. Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar

bazuar në Nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, në Nenin 39, pika 8 dhe Nenin 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “**Për Sistemin e Taksave Vendore**” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse, për vitin 2025 dhe këstet e maturuara të vitit 2026.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Faturën tatimore që i korespondon situacionit përfundimtar dhe të deklaruar në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratën përkatëse
- Situacionin përfundimtar
- Faturën tatimore që i korespondon situacionit përfundimtar dhe të deklaruar në organet tatimore

- Aktin e kolaudimit
 - Formular vlerësimi
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë, shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe në Nenin 55, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme, të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, operatorit ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e Nenit 88 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni, Autoriteti Kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatorit ekonomik ofertues, është kërkuar edhe miratimi nga ana e Autoritetit Kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të Nenit 89 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a dhe b.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të**

subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 2 A** Ndërtime civile e industriale
- **N.P - 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues
- **N.S - 8 A** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Për operatorët e huaj, të bëhet njehsimi/ekuivalentimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit që merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, Nenin 39, pika 6, gërma a, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, si edhe në VKM Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse, janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar, kategoria **N.P - 2 A “Ndërtime civile e industriale”**: *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv të objektit: **“Rikonstruksion dhe ndërtim çatie për ndërtesën (objektin) e Njesisë Administrative Gradishtë”**, konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë në preventivat:

- Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla marseljeze
- Shtrese me pllaka porcelanat
- Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25
- Boje hidroplastike
- Punime elektrike
- Punime hidraulike

Sipas VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar, kategoria N.P - 3 A **“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”**: *Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihet zëri me emërtesë tek objekti: **“Rikonstruksion dhe ndërtim çatie për ndërtesën (objektin) e Njesisë Administrative Gradishtë”**, në zërat për secilin emërtesë “Ngritje kantieri”, “Punime Hidroizolimi dhe Çatije”, “Punime shtresash”, “Punime tavani dhe suvatimi”, “Punime Bojatisje”, etj.

Sipas VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar, kategoria N.S - 4 A **“Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”**: *Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.*

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë: **“Rikonstruksion dhe ndërtim çatie për ndërtesën (objektin) e Njesisë Administrative Gradishtë”** në zërin “Punime shtresash”, “Punime tavani dhe suvatimi”, “Punime bojatisje”, “Punime Hidroizolimi dhe Çatije”.

Sipas VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar, kategoria N.S - 8 A **“Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”**: *Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë “Punime Hidroizolimi dhe Çatije”.

Sipas VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar, kategoria N.S - 14 A **“Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”**: *Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë: **“Rikonstruksion dhe ndërtim çatie për ndërtesën (objektin) e Njesisë Administrative Gradishtë”**, këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë “Punime Elektrike” dhe “Punime Hidraulike”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 2 A	Ndërtime civile e industriale	- <u>Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze+ristela druri</u> - <u>Shtrese me pllaka porcelanat</u> - <u>Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llac perzier M 25</u> - <u>Boje hidromat</u> - <u>Punime elektrike</u> - <u>Punime hidraulike</u>	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

N.P - 3 A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	<u>“Ngritje kantieri”, “Punime Tavani dhe Çatije”, “Punime shtresash”, “Punime tavani dhe suvatimi”, “Punime Bojatisje”</u>	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues	<u>“Punime shtresash”, “Punime suvatimi”, “Punime bojatisje”, “Punime Tavani dhe Çatije”</u>	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 8 A	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	<u>“Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla marseljeze+ristela druri”</u>	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 14 A	Implante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	<u>-Punime Elektrike</u> <u>-Punime Hidraulike</u>	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare në profilin përkatës, Librezë pune dhe Cv. Konkretisht, lloji i diplomës që duhet të paraqitet, është si më poshtë:
Inxhinier Ndërtimi – Diplomë Universitare në Inxhinieri Ndërtimi
Inxhinier Hidroteknik – Diplomë Universitare në Inxhinieri Hidroteknike
Inxhinier Elektrik – Diplomë Universitare në Inxhinieri Elektrike
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM-së Nr.42 datë 16.01.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”** e ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën **muajin e fundit të disponueshëm**, në

përputhje me afatet ligjore për deklarimin dhe pagesën e kontributeve, sipas Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, 9329, datë 6.12.2004, nr.9933, datë 26.6.2008, nr. 10/2012, date 9.2.2012, 87/2014, datë 17.7.2014, nr. 143/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.60, datë 16.9.2016, aktin normative nr. 1, datë 25.1.2017)” i përditësuar.

- Në lidhje me kërkesën për drejtues teknik 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, 1 (një) Inxhinier Ndertimi dhe 1 (një) Inxhinier Elektrik, nisur nga kategoritë e licencave të kërkuara për zbatimin e punimeve, si dhe referuar zërave të punimeve në preventiv, mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe me kontratë bashkëpunimi/kontratë pune, për ekzekutimin e kësaj kontrate objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Kontratën përkatëse, Diplomën Universitare në profilin përkatës, Librezë pune dhe Cv. Konkretisht, lloji i diplomës që duhet të paraqitet, është si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi – Diplomë Universitare në Inxhinieri Ndërtimi

Inxhinier Hidroteknik – Diplomë Universitare në Inxhinieri Hidroteknike

Inxhinier Elektrik – Diplomë Universitare në Inxhinieri Elektrike

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

- b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Teknik Ndërtimi”**

- Teknik Elektrik 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Teknik Elektrik”**
- Hidraulik 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Hidraulik”**
- Karpentier 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Karpentier”**
- Hidroizolues 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Hidroizolues”**
- Suvatues 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Suvatues”**
- Bojaxhi 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Bojaxhi”**
- Pllakashtrues 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Pllakashtrues”**
- Murator 1 (një) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin “Murator”**
- Punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to 4 (katër) me **Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional për profesionin përkatës**

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional Dëshmi/Certifikatë të kualifikimit profesional, për profesionin përkatës të kërkuar, lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.
- Stafi i mësipërm, duhet të jetë i përfshirë në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit të disponueshëm**, në përputhje me afatet ligjore për deklarimin dhe pagesën e kontributeve sipas Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, 9329, datë 6.12.2004, nr.9933, datë 26.6.2008, nr. 10/2012, date 9.2.2012, 87/2014, datë 17.7.2014, nr. 143/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.60, datë 16.9.2016, aktin normative nr. 1, datë 25.1.2017)” i përditësuar.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin**

publik” i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Argumentimi: Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në Nenin 39, pika 6, gërma c dhe ç të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, si edhe në VKM-në Nr.514, datë 20.9.2017 **“Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”**, të rishikuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime ndërtimi).
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike lidhur me zërat e preventivit të punimeve (Punime hidraulike dhe hidroizolimi).
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar preventivit të punimeve “Punime elektrike”.
- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Tekniku elektrik** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Hidroizoluesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Suvatuesi** është i nevojshëm për realizimin e suvatimeve, sipas zërave të preventivit.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes, sipas zërave të preventivit.

- **Pllakashtruesi** është i nevojshëm për realizimin e shtrimit të pllakave, sipas zërave të preventivit.
- **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muraturës, sipas zërave të preventivit.
- **Punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to** janë të nevojshëm për realizimin e çdo punimi tjetër që nuk ka nevojë për specialistë të profesioneve të sipërcituara, apo si ndihmesa në realizimin e punimeve nga specialistët në fjalë.

c) Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga Administratori i shoqërisë, **Përgjegjësin Teknik të Kantierit**, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr.2, datë 13.5.2005 **“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”**.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës c), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si edhe në Udhëzimin Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*.

d) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës, i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë kualifikimin përkatës si **“Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10 237, datë 18.2.2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”** (i përditësuar) dhe VKM Nr.312, datë 5.5.2010 **“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”** (i përditësuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën e punës,
- Dokumentin/certifikatën që vërteton kualifikimin përkatës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,*

autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar dhe në Nenin 39, pika 6 gërma c, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, kërkesa e mësipërme, mbështetet në Ligjin Nr.10 237, datë 18.2.2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”** (Ndryshuar me ligjin nr.161/2014, datë 4.12.2014; nr.99/2024, datë 12.9.2024) (i përditësuar) dhe VKM-në Nr.312, datë 5.5.2010 **“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”** (Ndryshuar me VKM nr.562, datë 3.7.2013; VKM nr.563, datë 3.7.2013; VKM nr.564, datë 3.7.2013; VKM nr.523, datë 6.8.2014) (i përditësuar). Natyra e kontratës dhe specifikat e saj, kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta, për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-në Nr.312, datë 5.5.2010 **“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”** (i përditësuar), është përcaktuar se, punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi, zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë, për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri, ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit, si edhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, sipas çertifikimit përkatës, shmang dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme, pasi shërben si garanci, që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funksioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë, ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

- e) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin **1 (një) mjek të përgjithshëm**, bazuar në VKM Nr.108, datë 9.2.2011 **“Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”** (i përditësuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare,

- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e bashkëpunimit/kontrata e punës e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës e), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM Nr.108, datë 9.2.2011 **“Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”** (Ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.7.2015) (i përditësuar), sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekësore për stafin e tyre, nëpërmjet punësimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë në këtë fushë.

f) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë:

- Shofera 2 (dy)

(Në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;

- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores ***“Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”***, miratuar me Urdhërin Nr.200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 ***“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*** i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 ***“Për prokurimin publik”*** i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës f), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është përcaktuar bazuar në pikën 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 ***“Për prokurimin publik”*** i ndryshuar dhe në Nenin 39, pika 6 gërma c të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 ***“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*** i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohe që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si edhe bazuar në rregulloren ***“Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”***, miratuar me Urdhërin Nr.200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

- g) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi me kohë të plotë punëtorë prej minimalisht **16 (gjashtëmbëdhjetë)** (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues). Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të paktën **muajin e fundit të disponueshëm**, në përputhje me afatet ligjore për deklarimin dhe pagesën e kontributeve sipas Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003, 9329, datë 6.12.2004, nr.9933, datë 26.6.2008, nr. 10/2012, datë 9.2.2012, 87/2014, datë 17.7.2014, nr. 143/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.60, datë 16.9.2016, aktin normative nr. 1, datë 25.1.2017)” i përditësuar.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **muajin e fundit të disponueshëm**. Përjashtim nga kjo bëjnë drejtuesit teknik 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, 1 (një) Inxhinier Ndertimi dhe 1 (një) Inxhinier Elektrik të kërkuar sipas gërmës “a”, “Mjeku i përgjithshëm” i kërkuar sipas gërmës “e”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listëpagesat e tij) mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe me kontratë bashkëpunimi/kontratë pune, për ekzekutimin e kësaj kontrate objekt prokurimi dhe punonjësit e kualifikuar si “Shofer”, të kërkuar sipas gërmës “f”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listëpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të Nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në Nenin 39, pika 6, gërma ç, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si edhe referuar grafikut të punimeve, të hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Divjakë. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, si edhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3,5-7 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Depozitë Uji 1000-2000 lita	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Betoniëre kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Moto/Gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Skela	600 m2	Në pronësi ose me qera
6	Zyrë e lëvizëshme (kontenier)	1 copë	Në pronësi ose me qera

- Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri 3.5-7 ton - Për transport materiale të imta si elektrike hidraulike.
- Depozitë Uji 1000-2000 lita - Për nevojat e kantierit, lagjen e betonit, etj.
- Betoniere kantieri - Për përdorim të prodhimit të betonit për nevoja të vogla brenda kantierit.
- Moto/Gjenerator - Për prodhim energjie për nevojat e kantierit.
- Skela - Për veshje fasade me polisterol, për lyerjen me bojë, suvatime të objektit dhe për shërbime të tjera në lartësi.
- Zyrë e lëvizëshme (kontenier) - Për nevojat e drejtuesit teknik dhe të stafit drejtues të kantierit.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Mjetet, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në këto rregulla, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në Nenin 39, pika 6, gërma d të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i fuqisë punëtore i kërkuar, mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike, operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme, janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe menaxhimit mjedisor. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim
- Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose **SSH EN ISO 45001:2023** mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim
- Çertifikatë **ISO 14001:2026** mbi “Sistemet e menaxhimit mjedisor”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Vendosja e Certifikatës ISO 9001:2015, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj certifikate, rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë. Pra, vendosja e kërkesës për paraqitjen e Certifikatës ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”, synon t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron kontrollin dhe monitorimin e proceseve gjatë realizimit të punimeve, respektimin e kërkesave teknike dhe specifikimeve të kontratës, si dhe identifikimin dhe trajtimin e mospërputhjeve, me qëllim garantimin e cilësisë së punimeve dhe realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e Certifikatës ISO 45001:2018 ose SSH EN ISO 45001:2023, përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë, të punonjësve të kompanisë, me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundësuar një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Në këtë kuptim, AK në vendosjen e këtij kriteri, kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të tyre. Pra, vendosja e kërkesës për paraqitjen e Certifikatës ISO 45001:2018 ose SSH EN ISO 45001:2023 mbi “Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”, synon t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik disponon një sistem të organizuar për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe procedura për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e punëmarrësve gjatë zbatimit të punimeve, me qëllim realizimin e sigurt dhe me sukses të kontratës.

Vendosja e Certifikatës ISO 14001:2026, na shërben për shkak se është e lidhur me mjedisin. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit, është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi, kurse metoda me e thjeshtë dhe me efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin, është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Përfitimet kryesore për këtë sistem menaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potenciale, komuniteti, autoritetet, zvogelimin e shpenzimeve nepermjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve, parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të cojë në pagesën për demshperblim dhe dëm, përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet. Pra, vendosja e kërkesës për paraqitjen e Certifikatës ISO 14001:2026 mbi “Sistemet e Menaxhimit Mjedisor” synon t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik disponon një sistem të organizuar të menaxhimit mjedisor, i cili mundëson identifikimin dhe kontrollin e aspekteve mjedisore gjatë realizimit të punimeve, menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga aktiviteti ndërtimor, parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve negative në mjedis, respektimin e kërkesave

ligjore mjedisore, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore, duke kontribuar në realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore. Për sa më sipër, kjo kërkesë është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit, është në proporcion me të dhe synon garantimin e realizimit të punimeve në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë, standardet e menaxhimit të mjedisit dhe standardet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në Nenin 44, pika 1, të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si edhe në Ligjin Nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”,* ku përcaktohet se, Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që Autoriteti Kontraktor, të krijojë sigurinë që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e mësipërme, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi, sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i këtyre certifikatave, rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet ti paraqesi ato. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

⇒ ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në zbatim të Nenit 2, pika 2, shkronja “c”, dhe Nenit 78, pika 2 dhe pika 3, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si edhe në funksion të dokumentimit të nevojës dhe përcaktimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ka hartuar specifikimet teknike për objektin: **“Rikonstruksion dhe ndërtim çatie për ndërtesën (objektin) e Njësisë Administrative Gradishtë”**, duke marrë në konsideratë natyrën, funksionin dhe karakteristikat e objektit, gjendjen ekzistuese të çatisë, nevojën për ndërhyrje në strukturën dhe mbulesën e saj, si dhe kërkesën për realizimin e punimeve në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e cilësisë për punimet e ndërtimit. Përcaktimi i specifikimeve teknike, synon të sigurojë që punimet e parashikuara të realizohen në mënyrë të plotë, të qëndrueshme dhe funksionale, duke garantuar mbrojtjen e ndërtesës nga agjentët atmosferikë, eliminimin e problematikave të shkaktuara nga amortizimi apo dëmtimi i çatisë ekzistuese, si dhe rritjen e jetëgjatësisë së objektit.

Për secilin zë punimi, janë përcaktuar kërkesat teknike minimale të nevojshme për të garantuar **qëndrueshmërinë mekanike, rezistencën ndaj kushteve atmosferike, izolimin nga uji dhe lagështira, qëndrueshmërinë në kohë dhe funksionalitetin e çatisë**. Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me funksionin që duhet të përmbushë objekti dhe nuk synojnë kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i materialeve dhe karakteristikave teknike, është bërë duke u bazuar në **funksionin dhe performancën që kërkohet të përmbushin**, dhe jo në një markë, prodhues apo burim të caktuar. Në rastet kur në specifikimet teknike mund të jetë e nevojshme referenca ndaj një standardi, norme teknike apo karakteristike të caktuara, kjo referencë kuptohet **“ose ekuivalente”**, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Nga relacioni teknik, rezulton se objekti është në gjendje të amortizuar. Në mënyrë të veçantë, **soleta ekzistuese është tërësisht e amortizuar dhe fut lagështirë në objekt**, duke bërë të nevojshme ndërtimin e një çatie për përmirësimin e kushteve të ndërtesës. Gjithashtu, lagështira ka shkaktuar dëmtime të suvatimeve dhe ka ndikuar në sistemin elektrik të objektit. Sipas relacionit teknik, projekti synon rehabilitimin e godinës së amortizuar për sigurimin e kushteve minimale për punonjësit e Njesisë Administrative. Në kuadër të ndërhyrjes parashikohet ndërtimi i një çatie të re në të gjithë sipërfaqen e objektit, rikonstruksioni i suvave të dëmtuara, realizimi i instalimeve të reja elektrike, rikonstruksioni i dyshemesë me pllaka gres porcelanat dhe instalimi i pajisjeve të reja hidrosanitare.

Këto specifikime përcaktojnë karakteristikat dhe kërkesat minimale të nevojshme për realizimin e punimeve, duke synuar garantimin e:

- qëndrueshmërisë së punimeve;
- mbrojtjes së ndërtesës nga lagështira dhe reshjet atmosferike;
- funksionalitetit të sistemit të ri të mbulimit;
- largimit të kontrolluar të ujërave të shiut;
- cilësisë së punimeve të suvatimit dhe bojatisjes;
- funksionimit të instalimeve elektrike dhe hidrosanitare;
- cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shtresave të dyshemesë;
- jetëgjatësisë së ndërhyrjes së realizuar.

Specifikimet teknike janë lidhur me zërat konkretë të preventivit, i cili parashikon ndër të tjera çati të re, ulluqe horizontale dhe vertikale, bojatisje, punime hidraulike, elektrike dhe shtrim me pllaka porcelanat.

ARGUMENTIMI SIPAS GRUPEVE TË PUNIMEVE

1. Punime tavani dhe suvatimi

Në preventiv janë parashikuar:

- **Suva brenda mur tulle ~ 4 m, me pompë, ll perzier M 25 – 1,600 m²**
- **Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompë – 620 m²**
- **Suvatim me grafiato h > 4 m – 750 m²**

Përcaktimi i këtyre punimeve, është i nevojshëm për shkak të dëmtimeve të shkaktuara nga amortizimi dhe lagështira në muret dhe sipërfaqet e objektit. Relacioni teknik, evidenton se, lagështira ka shkaktuar rënie të suvave dhe dëmtime në mure, ndaj është parashikuar rikonstruksioni i suvave dhe realizimi i suvave të reja, në rastet kur suvatimi ekzistues është dëmtuar plotësisht.

Kërkesat teknike për llaçin, trashësinë, drejtuesit dhe mënyrën e realizimit, janë përcaktuar me qëllim që sipërfaqet të jenë të niveluara, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për trajtimin përfundimtar. Specifikimet teknike për suvatimet e brendshme dhe të jashtme, përshkruajnë edhe përgatitjen e sipërfaqes, lagien me ujë, realizimin e shtresave dhe përdorimin e materialeve të përshtatshme, për arritjen e një përfundimi të qëndrueshëm.

Argumentimi: Këto kërkesa, janë vendosur për të garantuar riparimin e sipërfaqeve të dëmtuara, sigurimin e lidhjes së qëndrueshme ndërmjet shtresave të reja, nivelimin e sipërfaqeve dhe mbrojtjen e mëtejshme të mureve nga faktorët atmosferikë dhe lagështira.

2. Punime hidroizolimi dhe çatie

Në preventiv janë parashikuar:

- **Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla marseljeze” – 370 m²**
- **Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33 cm – 105 ml**
- **Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø100 – 55 ml**

Këto janë disa nga zërat kryesorë të ndërhyrjes. Përcaktimi i këtyre zërave është i domosdoshëm për funksionimin e sistemit të ri të çatisë.

Sipas relacionit teknik, gjendja e amortizuar e soletës dhe depërtimi i lagështirës në objekt kanë bërë të domosdoshëm ndërtimin e një çatie të re në të gjithë sipërfaqen e objektit. Specifikimet teknike për çatinë, parashikojnë konstruksionin mbajtës prej druri të stazhionuar dhe të përshtatshëm për përdorim në strukturën e çatisë, elementet lidhëse dhe mbulesën e sipërme me tjegulla të tipit të përcaktuar në specifikime.

Specifikimet teknike, parashikojnë pjerrësinë e nevojshme për largimin e ujërave, si dhe përdorimin e materialeve të përshtatshme për ulluqet horizontale dhe vertikale. Për ulluqet vertikale përcaktohen gjithashtu kërkesa për dimensionet dhe materialin, në mënyrë që të sigurohet shkarkimi i ujërave të çatisë dhe taracave.

Argumentimi: Përcaktimi i këtyre karakteristikave është i nevojshëm për të siguruar që çatia e re të ketë aftësi të mjaftueshme mbajtëse, qëndrueshmëri në kohë dhe rezistencë ndaj kushteve

atmosferike, si dhe të realizojë funksionin kryesor të mbrojtjes së ndërtesës nga reshjet dhe lagështira. Këto kërkesa, janë vendosur për të garantuar mbledhjen dhe largimin e kontrolluar të ujërave atmosferike, duke parandaluar grumbullimin e tyre në çati, depërtimin e ujit në ndërtesë dhe dëmtimin e mureve, suvatimeve dhe elementeve të tjera të objektit.

3. Punime bojatisje

Në preventiv është parashikuar:

- **Bojë hidroplastike – 2,020 m²**

Përcaktimi i këtij zëri, lidhet me përfundimin e sipërfaqeve pas punimeve të suvatimit dhe rehabilitimit. Specifikimet teknike, përcaktojnë kërkesa për përgatitjen e sipërfaqes, pastrimin, parapërgatitjen, hollimin dhe aplikimin e bojës, si dhe kërkojnë që sipërfaqja të jetë e përshtatshme për realizimin e një përfundimi uniform.

Argumentimi: Këto kërkesa synojnë sigurimin e ngjitjes së qëndrueshme të bojës në sipërfaqe, mbulimit të njëtrajtshëm, cilësisë së përfundimit dhe jetëgjatësisë së bojatisjes.

4. Analiza jashtë liste

Në preventiv janë parashikuar:

- **Punime Hidraulike – komplet 1.00**
- **Punime Elektrike – komplet 1.00**

Relacioni teknik përcakton se, në objekt, pajisjet hidrosanitare ekzistuese, janë pothuajse jashtë funksionit dhe parashikon implementimin e pajisjeve të reja hidrosanitare. Gjithashtu, relacioni teknik evidenton se, lagështira ka shkaktuar edhe prishje të sistemit elektrik dhe projekti parashikon realizimin e instalimeve të reja elektrike në përputhje me planimetrinë aktuale.

Specifikimet teknike, përcaktojnë kërkesa për tubacionet, rakorderitë, saraçineskat dhe pajisjet hidrosanitare, duke synuar garantimin e funksionimit normal dhe të sigurt të instalimeve. Specifikimet teknike përcaktojnë gjithashtu, kërkesa për çelësat, prizat dhe elementet e instalimit elektrik, duke synuar përshtatshmërinë e tyre për montim dhe përdorim të sigurt në ndërtesë.

Argumentimi: Përcaktimi i këtyre kërkesave, është i nevojshëm për të siguruar që instalimet e reja të jenë funksionale, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorimin e ndërtesës. Këto kërkesa janë të nevojshme për rikthimin e funksionalitetit të instalimeve elektrike dhe garantimin e sigurisë së përdoruesve të objektit.

5. Punime shtresash

Në preventiv është parashikuar:

- **Shtresë me pllaka porcelanat – 50 m².**

Relacioni teknik, parashikon rikonstruksimin e dyshemesë me shtrim me pllaka porcelanat.

Argumentimi: Përcaktimi i këtij zëri, është i nevojshëm për përfundimin e sipërfaqeve të dyshemesë të prekura nga ndërhyrja dhe për garantimin e një sipërfaqeje të qëndrueshme, funksionale dhe të përshtatshme për përdorimin e ndërtesës.

Në mënyrë të përmbledhur, këto punime dhe sasi të përkatëse, janë të reflektuara në preventivin përkatës të procedurës së prokurimit. Specifikimet teknike të përcaktuara për këtë procedurë prokurimi, janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, janë proporcionale me natyrën dhe vlerën e punimeve dhe janë të nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Specifikimet teknike u hartuan nga specialistët e fushës/struktura të specializuara/komision për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhërin Nr.314, datë 22.07.2026 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor “Për argumentimin e fondit limit si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit” me Nr.6185 Prot, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, e Nenit 2, pika 2, shkronja c, Nenit 39 pika 2, si edhe të Nenit 44 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar. Specifikimet teknike për punimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, si edhe janë në përputhje me parashikimet e Nenit 4, pika 38/a dhe Nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

*** Shënim:** Në respektim të Nenit 36, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: **“Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”, në të gjitha rastet kur përmendet “markë/origjinë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.**

NJËSIA E PROKURIMIT